

VENDIM
Nr.563, datë 28.5.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, TË DYTË DHE “MASTER I NIVELIT TË PARË”, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE, “KRISTAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private, “Kristal”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushat:

- a) Shëndet publik;
- b) Laborant mjekësor;
- c) Sociologji.

2. Kohëzgjatja e programeve të studimit të ciklit të parë të jetë 3 vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP) në:

- a) Shëndet publik;
- b) Laborant mjekësor;
- c) Sociologji.

3. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private, “Kristal”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushat:

- a) E drejtë civile;
- b) Marrëdhënie ndërkombëtare.

4. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë të jetë 2 vite akademike, me plotësimin, së paku, të 120 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht, diplomë e nivelit të dytë (DND) në:

- a) E drejtë civile.
- b) Marrëdhënie ndërkombëtare.

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private, “Kristal”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, me kualifikimin e nevojshëm.

6. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private, “Kristal”, Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë” në:

- a) Shëndet publik dhe menaxhim spitalor.

7. Programi i studimit “Master i nivelit të parë” është pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në mbarim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP) në “Shëndet publik dhe menaxhim spitalor”.

8. Shkolla e lartë universitare, private, “Kristal”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit të përcaktuara në pikat 1, 3 e 6 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

9. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Shkolla e lartë universitare, private, “Kristal”, duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në

ligjin në fuqi.

11. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha